

RAPORT I PËRKOHSHËM
3 - 31 mars 2020

30 prill 2020

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Zgjedhjet e parakohshme parlamentare ishin caktuar të mbaheshin më 12 prill. Më 21 mars, për shkak të paqartësive që u paraqitën për shkak të përhapjes globale të sëmundjes së koronavirusit (COVID-19), procesi zgjedhor u pezullua pa afat të caktuar me dekret të qeverisë. Vendimi ishte si rezultat i rekomandimeve unanime nga kryetari i shtetit dhe liderët e partive politike, duke përfshirë edhe opozitën, dhe i deklarave publike të administratës zgjedhore. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ODIHR-it (MVZ) u pezullua më 17 mars.
- Korniza ligjore pësoi rishikime thelbësore që nga zgjedhjet e mëparshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016, duke i përfshirë ndryshimet thelbësore në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020, një ditë para shpërbërjes së parlamentit dhe shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme. Këto ndryshime ndikuan në elementet kryesore të procesit zgjedhor, u ndryshuan kufijtë e disa njësive zgjedhore dhe u rishpërndanë disa përgjegjësi midis administratës zgjedhore dhe institucioneve shtetërore. Përkundër disa ndryshimeve pozitive, siç është regjistrimi i votuesve të cilëve u kishte skaduar afati i dokumenteve të identifikimit pas shpalljes së zgjedhjeve dhe mundësitë e zgjeruara për t'u ankuar kundër shkeljeve të fushatës, një numër i mangësive rregullatore qëndrojnë akoma dhe shumë rekomandime të ODIHR-it mbeten të patrajtuara. Disa bashkëbisedues të ODIHR-it shprehën shqetësime se ndryshimet u miratuan në mënyrë të nxituar, pa konsultim të gjerë dhe se propozimet nga grupi ndërinstitucional i punës, që kishte për detyrë të propozojë ndryshime të Kodit Zgjedhor, mbetën pa u shqyrtuar siç duhet.
- Para pezullimit të aktiviteteve zgjedhore, administrata zgjedhore në tre nivele, në krye me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), e kreu shumicën e aktiviteteve në përputhje me afatet ligjore. Masat qeveritare për ta parandaluar dhe për ta penguar përhapjen e COVID-19 ndikuan në punën e KSHZ-së dhe në formimin dhe trajnimin e komisioneve të niveleve më të ulëta, të cilat në disa raste u shtynë ose u pezulluan. Mbledhjet e KSHZ-së shpesh u thirrën duke i dërguar ftesat pak para se të mbahen ato, dhe jo të gjitha procesverbalet u vunë në dispozicion, mirëpo vendimet dhe rregulloret e KSHZ-së u publikuan në internet në kohë. KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se i mungonte kapaciteti institucional për t'i zbatuar në mënyrë të duhur kompetencat e shumta të reja që iu caktuan me ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Komisionet Zgjedhore Komunale (KZK) ishin funksionale, por disa i kufizuan aktivitetet e tyre për shkak të kufizimeve që lidheshin me shëndetin për sa i përket tubimeve publike dhe paqartësisë për vazhdimin e procesit zgjedhor.
- Regjistri i votuesve mirëmbahet nga KSHZ-ja; në momentin e pezullimit të procesit zgjedhor ai përfshinte rreth 1.8 milion qytetarë. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor parashikuan që votuesit, dokumentet e identifikimit të cilëve skaduan pas datës së shpalljes së zgjedhjeve, të përfshihen në regjistrin e votuesve. Ligji i rishikuar gjithashtu parashikon që regjistri i votuesve të nxirret nga regjistri qendror i popullsisë, i destinuar për ta ndihmuar harmonizimin e të dhënave të qytetarëve midis institucioneve të ndryshme shtetërore, mirëpo ky regjistër i popullsisë nuk është akoma funksional. Votuesit mund t'i kontrollojnë të dhënat e tyre dhe të

kërkojnë ndryshime gjatë gjithë vitit ose gjatë periudhës dy javore të këqyrjes publike; KSHZ-ja bëri me dije se do të shtohet një periudhë shtesë e këqyrjes publike pasi të vazhdohet procesi zgjedhor. KSHZ-ja planifikoi të mos zhvillojë votim jashtë vendit, pasi numri i kërkesave të aprovuara nuk e plotësoi pragun e kërkuar.

- Gjithsej u regjistruan 1.598 kandidatë në të gjashtë njësitë zgjedhore, në 78 lista të 12 partive politike dhe 3 koalicioneve. Kandidatët mund të emëroheshin nga partitë e regjistruara politike dhe koalicionet e tyre ose nga grupet e votuesve. Asnjë grup i votuesve nuk i mbledhi 1.000 nënshkrimet e nevojshme mbështetëse për të emëruar kandidat. KSHZ-ja prezantoi një aplikacion onlajn dhe udhëzime shtesë për ta lehtësuar procesin e regjistrimit të kandidatëve.
- Gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike. Megjithëse gratë përbënin 39 përqind të anëtarëve të parlamentit në largim, numri i tyre në poste të larta drejtuese, duke përfshirë postet e ministrave dhe të kryetarëve të komunave mbetet i ulët. Kërkesa për përfaqësim prej 40 përqind të secilës gjini në listat e kandidatëve u respektua plotësisht. Megjithatë, gratë ishin bartëse të listave në vetëm rreth 24 përqind të të gjitha listave të paraqitura.
- Periudha zyrtare e fushatës duhej të fillonte në 23 mars, mirëpo nuk filloi fare. Aktivitete të kufizuara nga partitë politike u zhvilluan para kësaj date, dhe u vu re retorikë negative midis figurave udhëheqëse të dy partive kryesore. Para pezullimit të zgjedhjeve, në dritën e kufizimeve shëndetësore për sa i përket tubimeve publike, të gjitha partitë ranë dakord të përmbahen nga vizitat në terren dhe nga tubimet publike, dhe në vend të kësaj të përqendrohen në fushatat përmes mediave tradicionale, atyre onlajn dhe rrjeteve sociale.
- Korniza kombëtare ligjore i përmend bashkësitë etnike, ndërsa Kushtetuta e garanton mbrojtjen e tyre. Ekzistojnë kërkesa për përfaqësim të drejtë të bashkësive etnike në disa komisione zgjedhore, duke u bazuar në përqindjen e tyre në popullsinë e komunave. Koalicionet e udhëhequra nga partia kryesore në pushtet dhe partia kryesore opozitare përfshinin parti që përfaqësonin pakicat kombëtare, dhe kandidatë nga këto bashkësi u përfshinë në listat zgjedhore përkatëse. Për herë të parë, u krijua një aleancë parazgjedhore midis një partie kryesisht të maqedonasve etnikë dhe një partie të shqiptarëve etnikë. Palët e interesuara vunë në dukje se anëtarët e bashkësive më të vogla etnike, veçanërisht romët, përballen me sfida për të marrë dokumente personale dhe për të regjistruar adresë, gjë që ndikon në përfshirjen e tyre në regjistrin e votuesve.
- Fushatat mund të financohen nga donacionet në para dhe ato në natyrë nga persona fizikë dhe juridikë, duke i përfshirë edhe mjetet e partive politike. Korniza ligjore parashikon masa të gjera parandaluese kundër keqpërdorimit të burimeve administrative. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor krijuan detyrime shtesë për raportim të përkohshëm, e shkurtuan afatin e fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare dhe e zhvendosën juridiksionin parësor për mbikëqyrjen e financimit të fushatës tek Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; Enti Shtetëror i Revizionit mbetet përgjegjës për kontrollin e mëvonshëm (*ex-post*).
- Mediat e ndryshme funksionojnë në një treg për reklamim që është duke u zvogëluar. Korniza ligjore parashikon mbulim të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm nga mediat. Reklammat e paguara politike në media gjatë fushatës janë plotësisht të subvencionuara nga shteti. Përcaktimi i çmimit maksimal për reklammat, siç parashikohet me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, shkaktoi pakënaqësi në mesin e transmetuesve kryesorë kombëtarë, të cilët e kontestuan pa sukses në

gjykatë zbatimin e kësaj rregulle nga KSHZ-ja. Organi rregullator i mediave nuk identifikoi asnjë shkelje nga mediat kryesore transmetuese në monitorimin e tij të përkohshëm.

- KSHZ-ja është organi në shkallë të parë për shqyrtimin e shumicës së kundërshtimeve zgjedhore, ndërsa Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i shqyrton kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Gjykata Administrative i shqyrton vendimet e tyre pas ankesës. Një numër kundërshtimesh që kishin të bënin me zgjedhjet u parashtruan para pezullimit të zgjedhjeve, edhe atë kryesisht në lidhje me regjistrimin e votuesve jashtë vendit, regjistrimin e mediave, përcaktimin e çmimeve për reklamat e paguara politike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Me ndryshimet e fundit u përcaktua që kompetencat e KSHZ-së t'i përfshijnë edhe shqyrtimin e ankesave për regjistrimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve.

II. HYRJE

Në përgjigje të ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) më 1 mars e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e udhëhequr znj. Tana de Zulueta, përbëhej nga 12 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin që nga 10 marsi. Anëtarët e misionit u siguruan nga 21 vende pjesëmarrëse të OSBE-së.

Pas futjes së kufizimeve për udhëtimet ndërkufitare në gjithë rajonin e OSBE-së për shkak të përhapjes globale të sëmundjes së koronavirusit (COVID-19), ODIHR-i i pezulloi përkohësisht aktivitetet e tij të vëzhgimit më 17 mars. ODIHR-i është e gatshëm të dërgojë përsëri mision vëzhgues në Maqedoninë e Veriut, në përputhje me direktivat për shëndetin dhe udhëtimet në rajon.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Maqedonia e Veriut është republikë parlamentare, me ç'rast kompetencat legjislativë i ka parlamenti me një dhomë - Kuvendi. Kryeministrit, i cili e udhëheq qeverinë, kryetari i shtetit ia beson formimin e qeverisë në bazë të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare.

Zgjedhjet paraprake parlamentare u mbajtën në dhjetor të vitit 2016. Në ato zgjedhje, megjithëse koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi më shumë mandate deputetësh, qeveria e re u formua në prill të viti 2017 nga koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM). Gjithsej, gjashtë parti dhe koalicione fituan përfaqësues në Kuvend.¹ Gratë përbënin 39 përqind të deputetëve të Kuvendit në largim.

Qëllimet kryesore strategjike të qeverisë në largim përfshinin zhbllokimin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Një hap i rëndësishëm në këto diskutime ndodhi me nënshkrimin e Marrëveshjes dypalëshe të Prespës me Greqinë në qershor të vitit 2018, pas së cilës Maqedonia e Veriut e miratoi emrin e saj të ri kushtetues.

¹ Në zgjedhjet e vitit 2016, koalicioni i VMRO-DPMNE-së fitoi 51 deputetë, koalicioni i LSDM-së 49, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) 10, BESA 5, Aleanca për Shqiptarët 3 dhe Partia Demokratike e Shqiptarëve 2 deputetë.

Vendimet për të shpallur zgjedhje të parakohshme parlamentare i parapriu vendimi i Këshillit të Evropës në tetor të vitit 2019 për të mos hapur negociata për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian (BE), i cili u vlerësua gjerësisht si një zhgënjim i rëndë për partinë në pushtet dhe e nxiti qeverinë në largim të japë dorëheqje. Më 3 janar të vitit 2020, kryeministri dha dorëheqje dhe një qeveri kalimtare, duke përfshirë edhe ministra të opozitës, e mori detyrën njëqind ditë para zgjedhjeve të planifikuara.² Më 16 shkurt, kryetari i parlamentit e shpërndau parlamentin dhe i shpalli zgjedhjet për 12 prill, rreth tetë muaj para skadimit të mandatit të Kuvendit. Zgjedhjet e shpallura do të ishin zgjedhjet e pesta radhazi parlamentare që nga viti 2008.

Përderisa zgjedhjet ishin të pezulluara, ndodhën disa zhvillime kyçe në këto procese të anëtarësimit. Më 24 mars, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së e miratoi hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut. Pas ratifikimit nga të gjithë shtetet anëtare të NATO-s të protokollit të pranimit të vendit, vendi zyrtarisht u bë anëtar i aleancës më 27 mars.

Periudha që u parapriu zgjedhjeve të planifikuara të parakohshme parlamentare ishte në hijen e përhapjes globale të sëmundjes së koronavirusit (COVID-19), e cila ndikoi në përgatitjet e zgjedhjeve, e bëri të detyrueshme vendosjen e kufizimeve për aktivitetet e fushatës dhe e zbehu pjesën më të madhe të diskursit tjetër politik.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Kuvendi është organ me një dhomë dhe përbëhet nga 120 deri në 123 deputetë, dhe zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta me mandat katërvjeçar sipas modelit të përfaqësimit proporcional duke përdorur lista të mbyllura. Njëzet deputetë zgjidhen nga secila nga gjashtë njësitë zgjedhore brenda vendit, dhe deri në tre deputetë zgjidhen nga njësia e vetme zgjedhore jashtë vendit. Mandatet për njësitë zgjedhore brenda vendit u shpërndahen listave të kandidatëve sipas metodës së *D'Hondt*-it, në bazë të mesatares më të lartë. Numri i deputetëve të zgjedhur në njësinë zgjedhore jashtë vendit është i kushtëzuar nga një prag që lidhet me rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme, por që nuk është i lidhur me pjesëmarrjen e votuesve.³

Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.⁴ Korniza ligjore për zhvillimin e

² Në vitin 2015, 2016 dhe 2018, Ligji për Qeverinë u ndryshua me dispozitat për krijimin e qeverisë kalimtare 100 ditë para zgjedhjeve, në përputhje me [Marrëveshjen e Përzhinës të vitit 2015](#).

³ Kandidati zgjidhet në njësinë zgjedhore jashtë vendit, nëse lista përkatëse merr të paktën numrin më të vogël të votave të fituara nga një deputet i zgjedhur brenda vendit në zgjedhjet e mëparshme; për këto zgjedhje pragu është 6.534 vota. Kandidati i dytë dhe i tretë zgjidhet nëse lista e tyre fiton dy herë dhe tre herë më shumë vota, përkatësisht. Në rast se asnjë listë në njësinë zgjedhore jashtë vendit nuk e fiton numrin e kërkuar të votave, nuk zgjidhet asnjë deputet. Ky sistem ishte [kritikuar](#) më parë nga ODIHR-i dhe Komisioni i Venedikut për shkak se nuk e garantonin të drejtën e votës për të gjithë votuesit me të drejtë vote në përputhje me parimin e universalitetit të votës. Procedura e regjistrimit dhe rezultati i tij u kontestuan në Gjykatën Administrative, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Shih seksionin *Kundërshtimet dhe Ankesat*).

⁴ Kjo përfshin Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, [Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike](#) (ICCPR) të vitit 1966, [Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#) (CEDAW) të vitit 1979, [Konventën e KB-ve për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#) (CRPD) të vitit 2006, [Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor](#) (CERD) të vitit 1965, [Konventën e KB-ve Kundër Korrupsionit](#) (UNCAC) të vitit 2003, dhe [Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punonjësve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre](#) të vitit 1990. Vendi është anëtar i [Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore](#) (KEDNJ) të vitit 1950 dhe i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Vendi gjithashtu merr pjesë në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe në Grupin e Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

zgjedhjeve parlamentare përfshin Kushtetutën e vitit 1991 (e ndryshuar për herë të fundit në vitin 2019), Kodin Zgjedhor të vitit 2006 (i ndryshuar për herë të fundit në shkurt të vitit 2020), Ligjin për Partitë Politike të vitit 2004, Ligji për Financimin e Partive Politike të vitit 2004 (i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2018), dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe rregulloret e miratuara nga KSHZ-ja për ta plotësuar ligjin.⁵

Para zgjedhjeve, korniza ligjore zgjedhore u ndryshua në mënyrë thelbësore si pjesë e reformës së vazhdueshme legjislative, për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, si parakusht për përparimin e pranimit në BE. Në shkurt të vitit 2020, në Kodin Zgjedhor u futën ndryshime të mëdha. Ndryshimet përfshinin shumicën e procedurave zgjedhore dhe me ato u rishpërndanë disa përgjegjësi kryesore midis administratës zgjedhore dhe organeve shtetërore (shih seksionin *Administrata Zgjedhore*). Disa ndryshime i trajtuan pjesërisht rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, të tilla si regjistrimi i votuesve të cilëve u kishte skaduar afati i dokumenteve të identifikimit pas shpalljes së zgjedhjeve dhe mundësitë e zgjeruara për t'u ankuar kundër shkeljeve të fushatës. Disa rekomandime të vazhdueshme të ODIHR-it mbeten të patrajuara, duke përfshirë, ndër të tjera, garancitë për barazinë e votës, eliminimin e paqartësive në rregullimin e procedurave të rekrutimit dhe shkarkimit të anëtarëve të administratës zgjedhore, dhe rregullat për financimin, revizionin dhe mbikëqyrjen e fushatës.⁶ Mbeten disa mangësi dhe mospërputhje të konsiderueshme në rregullimin e regjistrimit të votuesve dhe të kandidatëve, si dhe afatet kohore dhe ankesat që kanë të bëjnë me këtë, dhe disa procedura të votimit.

Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime se ndryshimet që u bënë në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020, u miratuan me procedurë të përshpejtuar pa diskutim të mjaftueshëm, në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it që një proces i tillë reformimi të jetë inkluziv dhe të zhvillohet një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve. Ndryshimet u miratuan në prag të shpërbërjes së parlamentit dhe më pak se dy muaj para ditës së planifikuar të zgjedhjeve.⁷ Propozimet e grupit ndërinstitutional të punës, që kishte për detyrë të propozojë ndryshime të Kodit Zgjedhor dhe që përbëhej nga përfaqësues të institucioneve

⁵ Korniza përkatëse ligjore u miratua ose u ndryshua në mënyrë thelbësore në vitin 2019 dhe 2020, duke përfshirë Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave në vitin 2019, Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në vitin 2019, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vitin 2020 dhe Ligjin për Prokurorinë Publike në vitin 2020. Ligje të tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet janë Ligji për Mediat, i ndryshuar në vitin 2014, Ligji për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale Mediatike, i ndryshuar në vitin 2020, dhe Ligji për Procedurën Administrative, i ndryshuar në vitin 2008. Për zgjedhjet e vitit 2020, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e rregulloi, ndër të tjera, regjistrimin e kandidatëve, zhvillimin e fushatës, procedurat për përcaktimin e identitetit të votuesve, votimin e personave me aftësi të kufizuara, votimin e të burgosurve, si dhe votimin në shtëpi dhe votimin në institucionet e përkujdesjes, përcaktimin e fletëvotimeve të pavlefshme, vëzhgimin e zgjedhjeve dhe zgjidhjen e kontesteve në lidhje me zgjedhjet nga KSHZ-ja dhe Komisionet Zgjedhore Komunale.

⁶ Për më tepër, ndryshimet nuk i përfshinë rekomandimet e ODIHR-it për t'u dhënë të drejtë vote edhe personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose psiko-sociale, për përcaktimin e metodologjisë për ndryshimin e kufijve të njësive zgjedhore nga një organ i pavarur, dhe harmonizimin e Kodit Zgjedhor, në brendinë e tij dhe me ligjet e tjera përkatëse përmes një analize gjithëpërfshirëse dhe inkluzive.

⁷ Propozim-ligji u [miratua](#) në orën 4:30 të mëngjesit, më 15 shkurt, ndërsa Kuvendi u shpërbë të nesërmen. Ligji hyri në fuqi pas botimit zyrtar më 16 shkurt të vitit 2020. Neni 170 i [Rregullores](#) së Kuvendit përcakton procedurë të shkurtuar vetëm për propozim-ligjet që nuk janë të ndërlikuara dhe vëllimore; që kanë të bëjë me shfuqizimin e ndonjë ligji ose dispozitave të veçanta të ndonjë ligji; ose nëse nuk janë në pyetje harmonizime komplekse dhe vëllimore të ligjit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ndërsa për propozim-ligjet me interes të gjerë publik, është përcaktuar mbajtja e debatit publik (neni 145).

shtetërore, administratës zgjedhore dhe shoqërisë civile nuk u përfshinë.⁸ Miratimi i nxituar e pengoi zbatimin efektiv të ndryshimeve, pasi disa mangësi të mëparshme rregullatore nuk u eliminuan, nuk u sigurua gjithnjë kapaciteti administrativ dhe infrastruktura, dhe disa procese të prokurimit nuk arritën të përfundonin me kohë.⁹

Kodi Zgjedhor lejon devijim deri në pesë përqind nga numri mesatar i votuesve në një njësi zgjedhore. Në katër njësi zgjedhore kishte pabarazi më të mëdha.¹⁰ Me ndryshimet që u bënë në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 u ndryshuan kufijtë e dy njësive zgjedhore, duke i zhvendosur dy komuna, atë të Dibrës dhe Mavrovë-Rostushës, nga njësia zgjedhore numër gjashtë në njësinë zgjedhore numër pesë.¹¹ Përkundër devijimit mbi kufirin ligjor në njësitë zgjedhore numër tre dhe katër, kufijtë e këtyre njësive zgjedhore mbetën të pandryshuara.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet menaxhohen nga administrata në tre nivele, e udhëhequr nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), dhe e përbërë nga 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe 3.480 Këshilla Zgjedhorë (KZ). Që nga viti 2018, KSHZ-ja ka shtatë anëtarë të emëruar nga partitë politike parlamentare: katër nga partitë në pushtet, duke përfshirë nënkryetarin dhe tre nga partitë opozitare, duke përfshirë edhe kryetarin. Tre nga anëtarët aktualë të KSHZ-së janë gra, duke përfshirë edhe nënkryetaren. Mandati i KSHZ-së aktuale, i cili fillimisht ishte caktuar për gjashtë muaj për ta administruar referendumin e vitit 2018, në nëntor të vitit 2018 u zgjat më së shumti deri në dy vjet.¹² Deri në pezullimin e procesit zgjedhor, KSHZ-ja e realizoi shumicën e përgatitjeve në përputhje me afatet ligjore. Pavarësisht nga kjo, të gjitha nivelet e administratës zgjedhore u përballën me disa vështirësi në përmbushjen e mandateve të tyre në dritën e masave të shëndetit publik në lidhje me parandalimin dhe pengimin e përhapjes së COVID-19.

Me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor u rishpërndanë disa përgjegjësi kryesore midis komisioneve zgjedhore dhe organeve shtetërore dhe KSHZ-së iu caktuan një spektër i gjerë i kompetencave të reja. Këto detyra të reja përfshijnë hetimin e shkeljeve të pretenduara dhe shqyrtimin e provave në mekanizmat e zgjidhjes së kontesteve, inicimin e procedurave për parregullsitë zgjedhore sipas detyrës zyrtare, dhe përcaktimin e çmimeve për reklamat politike në

⁸ Grupi i punës u krijua në bazë të Marrëveshjes së Përzhinës të vitit 2015 dhe u riformua pas një [marrëveshjeje më 20 korrik të vitit 2016](#) midis katër partive kryesore politike. Grupi i punës e vazhdoi punën e tij në vitin 2018 dhe 2019 nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë. Së paku nëntë institucione të interesit përgatitën dhe dorëzuan komente dhe propozuan ndryshime në Kodin Zgjedhor përpara shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2020, duke përfshirë kërkesat për dorëzimin e raporteve për financimin e fushatës dhe procedurat e revizionit dhe funksionet mbikëqyrëse të organeve të përfshira, masat kundër klientelizmit gjatë mbulimit të fushatës, rregulloret dhe mbikëqyrjen e fushatës, dhe mbrojtjen e të drejtave të votimit.

⁹ Për shembull, sipas KSHZ-së, procedurat e identifikimit të votuesve sipas nenit 108-a nuk mund të kryeshin pasi nuk ishin blerë pajisjet e nevojshme, dhe sistemi onlajn për parashtrimin dhe ndjekjen e kundërshtimeve nuk ishte vënë në funksion.

¹⁰ Sipas KSHZ-së, në shkurt të vitit 2020, teprica në njësinë zgjedhore (NjZ) nr.6 ishte 8.60 përqind, ndërsa në NjZ nr.2 ai ishte 5.74 përqind. Përqindje më të vogla se kufiri ligjor u raportuan në NjZ nr.4 (6.36 përqind) dhe në NjZ nr.3 (7.64 përqind). Njësitë zgjedhore nr.1 dhe nr.5 ishin brenda kufirit ligjor të devijimit.

¹¹ Për ndryshimin e kufijve në NjZ nr.6 lloboi BDI-ja, partia më e madhe parlamentare e shqiptarëve etnikë, dhe kjo u konsiderua gjerësisht si një kompromis politik. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re se ndryshimet në NjZ nr.6 potencialisht do t'u mundësonin partive të shqiptarëve etnike të fitojnë rreth dy mandate shtesë. Propozimi për unifikimin e të gjitha njësive zgjedhore, duke përfshirë edhe njësinë zgjedhore numër 7 jashtë vendit, në një njësi të vetme në mbarë vendin, nuk arriti të fitojë konsensus në Kuvend.

¹² Për ta mundësuar shtyrjen e zgjedhjeve, me dekretin e qeverisë të datës 21 mars 2020, u ndryshua përsëri mandati i anëtarëve të KSHZ-së, i cili do të skadojë gjashtë muaj nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme parlamentare (shih *Pezullimi i procesit zgjedhor*).

mediat transmetuese, të shkruara dhe në internet (onlajn). KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se i mungojnë udhëzimet ligjore dhe kapaciteti institucional për t'i kryer në mënyrë adekuate këto detyra dhe ishte e mendimit se në disa raste, siç është zgjidhja e kundërshtimeve ose çështjet që kanë të bëjnë me mediat, organet e specializuara profesionale do të ishin më të përgatitura të merren me to.

Të gjitha mbledhjet e KSHZ-së u lajmëruan paraprakisht në media dhe përmes listës zyrtare të e-mail-eve, megjithëse pak para se te mbahen mbledhjet, zakonisht në të njëjtën ditë. Pas masave të qeverisë për t'i kufizuar tubimet, mbledhjet e KSHZ-së u transmetuan drejtpërdrejt në ueb-faqen e Agjencisë Shtetërore të Lajmeve (MIA) dhe në faqen e KSHZ-së në "Facebook", pa praninë fizike të mediave ose të vëzhguesve.¹³ KSHZ-ja i publikoi procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të mbajtura deri më 6 mars. Procesverbalet e gjashtë seancave të mbajtura pas kësaj date nuk u publikuan, por të gjitha rregulloret dhe vendimet e KSHZ-së u miratuan dhe u publikuan në internet në kohë.

KSHZ-ja hartoi një doracak për shqyrtimin e kundërshtimeve që tani janë në kompetencën e KZK-ve, ku u trajtua mungesa e qartësisë për këtë çështje. Për ta lehtësuar dorëzimin dhe formulimin e kërkesave nga individët dhe për ta zvogëluar numrin e rasteve që konsiderohen të papranueshme për arsye formale, KSHZ-ja hartoi një numër shabllonesh dhe formularësh, duke përfshirë edhe për regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve dhe për kundërshtimet. Megjithatë, jo të gjitha vendimet e KSHZ-së dhanë detaje të mjaftueshme për ta kompensuar mungesën e një udhëzimi të qëndrueshëm ligjor.¹⁴

KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale me mandat prej pesë vjetësh. KZK-të e mbikëqyrin administrimin e zgjedhjeve në komunën përkatëse, i emërojnë dhe i trajtojnë KZ-të, dhe menaxhojnë me përgatitjet e tjera teknike. KZ-të përbëhen nga tre anëtarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë me mandat katërvjeçar, si dhe dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga dy partitë (në pushtet dhe opozitare) që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet paraprake parlamentare. Anëtarët aktualë nga radhët e nëpunësve publikë të KZK-ve dhe KZ-ve janë emëruar në vitin 2017.

Sipas KSHZ-së, të gjitha KZK-të filluan me punën e tyre sipas planit të paraparë. Edhe pse plotësisht funksionale në fazat fillestare të procesit, disa KZK që u vizituan nga MVZ-ja e ODIHR-it filluan t'i kufizojnë ose t'i ndalojnë pjesërisht aktivitetet e tyre për shkak të masave të shtuara shëndetësore, të miratuara për arsye të përhapjes së pandemisë dhe paqartësisë për vazhdimin e zgjedhjeve.

Niveli i transparencës së aktiviteteve të KZK-ve ndryshonte varësisht nga komuna, ndërsa praktikat e vendimmarrjes nëpër KZK nuk ishin gjithnjë konsekuente. Në disa raste, procesverbalet e mbledhjeve u postuan në tabelën e shpalljeve, ndërsa në raste të tjera ato u dërguan në KSHZ. Në raste të caktuara, anëtarët nuk ishin të pranishëm në mbledhje ose mbërritën me vonesë, që ndonjëherë rezultoi me mungesë të kuorumit. Duket se në disa raste, vendimet e marra nga një numër i vogël i anëtarëve u miratuan më vonë në letër nga anëtarët e tjerë, pa pjesëmarrjen e tyre në

¹³ Më 10 mars, midis masave të tjera që kishin për qëllim parandalimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19, qeveria vendosi ndalesë për tubime të mëdha publike dhe rekomandoi anulimin e të gjitha tubimeve pavarësisht nga madhësia e tyre.

¹⁴ Disa vendime të KSHZ-së nuk përmblanin të dhëna relevante; për shembull, në vendimin për regjistrimin e votuesve jashtë vendit nuk ishte përmendur numri i saktë i kërkesave të vlefshme që nevojiten për të zhvilluar votime jashtë vendit; rregulloret mbi kundërshtimet nuk parashikonin afat të qartë për transferimin e kundërshtimeve nga komisioni i shkallës së parë në organin e apelit.

procesin e vendimmarrjes. Një numër i konsiderueshëm i KZK-ve të vizituara iu ankuan ODIHR-it për nivele të ulëta të financimit, si dhe për hapësira dhe pajisje joadekuate.

Afati i fundit për formimin e KZ-ve ishte 8 marsi. Edhe pse shumica e KZ-ve ishin formuar nga KZK-të brenda afatit ligjor, në disa raste procesi u vonua, sipas KSHZ-së, për shkak të bazës së vjetruar të të dhënave të nëpunësve publikë.¹⁵ Përveç kësaj, qeveria mori vendim për ta tërhequr gjithë personelin e kualifikuar mjekësor nga KZK-të dhe KZ-të për shkak të nevojës së ngutshme që personeli mjekësor të jetë i disponueshëm për përballjen me COVID-19, që preku rreth 15 deri në 20 përqind të anëtarëve të KZK-ve dhe të KZ-ve, e në disa komuna edhe deri në 45 përqind.¹⁶

Sipas Kodit Zgjedhor, përbërja e çdo organi për menaxhimin e zgjedhjeve duhet t'i respektojë kërkesat ligjore për përfaqësimin etnik dhe gjinor.¹⁷ Çdo gjini duhet të përbëjë të paktën 30 përqind të të gjitha KZK-ve dhe KZ-ve. Përfaqësimi i drejtë i bashkësive etnike kërkohet për të gjitha KZK-të dhe KZ-të në komunat në të cilat të paktën 20 përqind e popullsisë janë pjesëtarë të bashkësive të tilla.¹⁸ Në rast të mungesës së anëtarëve të përshtatshëm nga administrata publike, zgjidhen anëtarë nga komunat e tjera me profilin e kërkuar.

KSHZ-ja e pezulloi trajnimin e të gjitha KZ-ve më 11 mars, deri kur ishin mbajtur vetëm trajnime të kufizuara në disa komuna, ndërsa para pezullimit të zgjedhjeve KSHZ-ja ishte duke i shqyrtuar opsionet e trajnimit në distancë për t'i zëvendësuar trajnimet me pjesëmarrje fizike të anëtarëve. Materialet e trajnimit u përgatitën në gjuhën maqedonase, shqipe, rome, serbe dhe turke. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it i mirëpritën planet për trajnime më të gjera sesa në zgjedhjet paraprake, ku duhej të trajnohen të gjithë anëtarët e KZ-ve. Në numrin e kufizuar të trajnimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, roli i ri, i futur rishtazi, i KZK-ve për shqyrtimin e kundërshtimeve jo gjithmonë u trajtua ashtu siç duhet, ndërsa vëzhguesit e ODIHR-it raportuan se në mesin e KZK-ve nuk kishte kuptim të njëjtë për këtë ndryshim procedural.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Qytetarët që kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve dhe që kanë vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore kanë të drejtë të votojnë, përveç nëse kjo e drejtë ligjore u është marrë me vendim gjyqësor. Me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor u përcaktua se duhet të bëhet regjistrimi i votuesve, të cilëve u kishte skaduar afati i dokumenteve të identifikimit gjatë periudhës nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, duke e trajtuar kështu pjesërisht një rekomandim paraprak të ODIHR-it. Më tej, ndryshimet parashikuan përfshirjen në kohë në listën e votuesve të të dhënave të votuesve që kanë bërë kërkesë ose kanë marrë dokumente të reja të identifikimit nga shpallja e zgjedhjeve deri në mbylljen e këqyrjes publike. Megjithatë, regjistrimi i votuesve në vendvotime mbetet i kushtëzuar me vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit.¹⁹

¹⁵ Anëtarët e KZ-ve zgjidhen rastësisht. KSHZ-ja deklaroi se në disa komuna deri në 70 përqind të anëtarëve të KZ-ve ishin rekrutuar nga të njëjtat institucione. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it deklaruan se sanksionet e rrepta për shkeljet e administratës zgjedhore, si dhe frika e presionit nga partitë politike, potencialisht i dekurajojnë punonjësit publikë që të bëhen anëtarë të KZ-ve.

¹⁶ Në mbledhjen e mbajtur më 15 mars, KSHZ-ja përmendi se duhet të zëvendësohen rreth 3.200 profesionistë mjekësorë.

¹⁷ KSHZ-ja kreu një revizion të brendshëm të politikave të punës në fund të vitit 2019, i cili identifikoi masa për ta monitoruar dhe për ta avancuar integritimin dhe ndjeshmërinë gjinore në praktikën e saj administrative.

¹⁸ Kjo kërkesë nuk ishte respektuar në disa komisione të vizituara nga MVZ-ja e ODIHR-it. Kodi Zgjedhor gjithashtu parashikon që fletëvotimet të shtypen në gjuhë tjetër në komunat ku të paktën 20 përqind e qytetarëve flasin gjuhën e tillë.

¹⁹ Ndryshimet e vitit 2020 në Kodin Zgjedhor parashikojnë zbatimin e regjistrimit biometrik të votuesve në vendvotime, duke përdorur verifikimin përmes skanuesve për gjurmët e gishtave, si dhe për dokumentet biometrike të identifikimit. KSHZ-ja nuk planifikoi t'i zbatojë këto dispozita për këto zgjedhje.

Sistemi i regjistrimit për votimin në vend është pasiv dhe i vazhdueshëm, dhe bazohet në informatat e nxjerra nga regjistrat civilë dhe regjistrat e tjerë kombëtarë. KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjykatat dhe Zyrën për Udhëheqje me Librat e Gjendjes Civile, e cila e administron përpunimin logjistik, teknik dhe metodologjik të të dhënave. Ndryshimet e vitit 2020 kërkojnë që regjistri i votuesve të gjenerohet automatikisht nga Regjistri qendror i popullsisë (RQP). Megjithatë, kjo dispozitë nuk është implementuar akoma; RQP-ja elektronike u lëshua zyrtarisht në tetor të vitit 2019, por nuk është funksionale, pasi nuk ka përfunduar mbledhja e të dhënave që është e nevojshme për sinkronizim me bazat e tjera burimore të dhënave.²⁰ Ligji përcakton katër përditësime të rregullta, si dhe një periudhë shtesë për dorëzimin e të dhënave për zgjedhje të organizuara jashtë ciklit të raportimit, që synojnë sigurimin në kohë të të dhënave të përditësuara të regjistrimit të votuesve nga të gjitha organet përgjegjëse.

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në regjistrin e votuesve, personalisht ose onlajn, dhe të kërkojnë ndryshime gjatë gjithë vitit. Në periudhën ndërmjet 26 shkurtit dhe 11 marsit, listat e votuesve ishin në dispozicion për këqyrje publike në zyrat rajonale KSHZ-së.²¹ Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja siguroi kopje të regjistrit paraprak të votuesve për gjashtë parti parlamentare, me kërkesë të tyre, pas përfundimit të këqyrjes publike. Megjithatë, KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se regjistri i votuesve nuk është përfundimtar dhe se, me gjasë, do të ketë një periudhë shtesë të këqyrjes publike pasi të vendoset një afat kohor i ri për zgjedhjet e shtyra dhe pasi të vazhdojnë përgatitjet që lidhen me to.²² Regjistri përfshinte 1.821.981 votues në momentin kur KSHZ-ja i pezulloi operacionet e saj.

Qytetarët me vendbanim të përhershëm në vend dhe me dokument të vlefshëm të identifikimit, që banojnë përkohësisht jashtë vendit, janë përfshirë në regjistrat e veçanta të votuesve brenda vendit, përveç nëse nuk aplikojnë që të regjistrohen për të votuar në përfaqësitë e caktuara diplomatike ose konsullore. Pragu prej 6.534 votuesve të regjistruar që nevojitet për të zhvilluar votim jashtë vendit nuk u arrit. Prandaj, KSHZ-ja vendosi se votimi jashtë vendit nuk do të mbahet. Nga 7.535 aplikime të pranuar nga 16 shkurti deri më 11 mars, KSHZ pranoi 6.096 aplikime dhe refuzoi 1.439. KSHZ-ja e përmendi numrin e madh të aplikimeve të dërguara nga një llogari e vetme e e-mail-it (duke filluar nga 300 deri në 800 aplikime për llogari), që është në kundërshtim me kërkesën që çdo aplikim të dërgohet nga një adresë përkatëse personale e e-mail-it, si arsye për përqindjen e lartë të aplikimeve të refuzuara për votim.

²⁰ RQP-ja është rregulluar me Ligjin për Regjistrin Qendror të Popullsisë të miratuar në maj të vitit 2019 dhe është zhvilluar dhe mirëmbahet nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. RQP-ja bazohet në të dhënat e sinkronizuara të Regjistrit të Adresave dhe Regjistrit të të Dhënave Hapësinore dhe nuk mund të jetë funksionale deri sa të përfundojnë këto regjistra të tjerë. Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, finalizimi i projektit u shty për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe çështjeve të identifikuara gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave për projektin pilot të regjistrit të adresave të realizuar në katër komuna, Gostivar, Kisella Vodë, Sveti Nikole, dhe Zelenikovë, etj. ku rreth 70 përqind e ndërtesave dhe rrugëve duket se nuk kishin identifikim. Në janar të vitit 2020, Agjencia për Kadastër të Patundshmërisë [njoftoi](#) mbledhjen e të dhënave gjeo-hapësinore në 11 rajone deri në prill të vitit 2020.

²¹ KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se nuk kishte bërë përmbledhje të të dhënave se sa votues kërkuan ndryshime të të dhënave të tyre përmes internetit ose personalisht. Vëzhgimi nga MVZ-ja e ODIHR-it sugjeroi se këto numra ishin shumë të ulët, madje të papërfillshëm.

²² Neni 31 i Kodit Zgjedhor i jep KSHZ-së përgjegjësi të vetme për mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve, e obligon KSHZ-në të kryejë përditësim mujor të regjistrit të zgjedhësve dhe i jep të drejtë KSHZ-së të kryejë verifikime shtesë të të dhënave me bazat e të dhënave të të gjitha organeve përgjegjëse publike për t'i zgjidhur mospërputhjet.

Organizatat e shoqërisë civile që u takuan me MVZ-në e ODIHR-it prezantuan sfida të vazhdueshme për anëtarët e bashkësive më të vogla etnike, veçanërisht për romët, për të marrë dokumente personale, si dhe pengesa në regjistrimin e adresave për banesat e ndërtuara rishtas, duke ndikuar potencialisht në gjithëpërfshirjen e regjistrit të votuesve.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Qytetarët që kanë mbushur 18 vjet dhe që kanë të drejtë vote, kanë të drejtë të kandidojnë, duke i përjashtuar ata të cilëve u është revokuar e drejta e votimit për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale ose psiko-sociale, që është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare dhe rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Përveç kësaj, korniza ligjore ua heq të drejtën e kandidimit atyre që aktualisht vuajnë dënime me burg prej më shumë se gjashtë muajsh.

Kandidatët mund të emëroheshin nga partitë e regjistruara politike dhe koalicionet, si dhe grupet e votuesve, në vend dhe jashtë vendit. Kodi Zgjedhor nuk i harmonizon afatet për regjistrimin e votuesve dhe emërimin e kandidatëve.²³ Kandidatët e emëruar nga votuesit duhet të mbledhin së paku 1.000 nënshkrime mbështetëse nga votuesit që banojnë në njësinë përkatëse zgjedhore. Për herë të parë, duke e zbatuar një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, nënshkrimet mbështetëse të votuesve mund të mblidheshin në zyrat e noterëve, si dhe përpara punonjësve të KSHZ-së, në zyrat kompetente rajonale të KSHZ-së.²⁴ Në fund të periudhës së regjistrimit, asnjë grup i votuesve nuk pati sukses të emërojë listë kandidatësh, pasi asnjë grup nuk arriti ta mbledhë numrin e kërkuar të nënshkrimeve.²⁵

Regjistrimi i kandidatëve u bë nga 12 deri më 20 mars.²⁶ Për këto zgjedhje, KSHZ-ja lëshoi një aplikacion të ri onlajn për parashtrimin e listave të kandidatëve.²⁷ Megjithëse Kodi Zgjedhor nuk specifikon listë të dokumenteve të nevojshme për emërimin e kandidatëve, KSHZ-ja lëshoi udhëzim ku ishte shënuar lista e dokumenteve të nevojshme për kandidatët dhe ku ishin dhënë hollësitë e procedurës së verifikimit. Deri më 20 mars, brenda afatit ligjor, KSHZ-ja regjistroi 12 parti politike dhe 3 koalicione, të cilat paraqitën gjithsej 1.598 kandidatë në 78 lista. KSHZ-ja i publikoi të gjitha listat e kandidatëve në ueb-faqen e saj me një mjet interaktiv i cili shfaqte të dhënat e kandidatëve sipas përkatësisë partiake, gjinisë, njësisë zgjedhore dhe komunës.

Në përgjithësi, gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike.²⁸ Masat në Kodin Zgjedhor për ta promovuar barazinë gjinore në listat e partive e rritën përfaqësimin e grave

²³ Sipas Kodit Zgjedhor, emërimi i kandidatëve përfundon para përfundimit të regjistrimit të votuesve.

²⁴ Paguesa e tarifave të noterit është përgjegjësi e grupeve të votuesve që i emërojnë kandidatët. Të paktën 1.000 votues jashtë vendit kërkohet të nënshkruajnë për kandidatët e propozuar përpara zyrtarëve në zyrat diplomatike ose konsullore.

²⁵ Gjashtë kandidatë nuk patën sukses [të regjistrohen përmes mbledhjes së nënshkrimeve](#). Numri maksimal i nënshkrimeve të mbledhura ishte 255 në njësinë zgjedhore numër 4, ndërsa numri i përgjithshëm i nënshkrimeve të mbledhura nga të gjithë kandidatët individualë në gjithë vendin ishte 536, me ç'rast dy kandidatë nuk arritën të mbledhin asnjë nënshkrim.

²⁶ Të gjitha 78 listat e parashtruara nga partitë politike u pranuan.

²⁷ Aplikacioni kishte për qëllim ta lehtësojë paraqitjen dhe verifikimin e dokumentacionit për emërimin e kandidatëve dhe të sigurojë shpërndarje automatike të mandateve sipas formulës së *D'Hondt*-it. Aplikacioni nuk u përdor gjerësisht nga paraqitësit e listave dhe KSHZ-ja më në fund i transferoi të dhënat në aplikacionin onlajn në mënyrë manuale.

²⁸ Shih gjithashtu paragrafin 29 të [Vëzhgimeve përmbyllëse të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 2018](#), i cili vuri në dukje se "gratë mbeten të papërfaqësuara në mënyrë adekuate në Kuvend, në Kabinet dhe në këshillat komunalë, në mesin e kryetarëve të komunave, në pozitë vendimmarrëse në shërbimin diplomatik dhe në gjyqësi." Paragrafi 21 vë në dukje gjithashtu "këmbënguljen në stereotipe diskriminuese gjinore në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave në familje, në sistemin arsimor dhe në shoqëri".

në parlamentin në largim, ku kishte 47 gra nga 120 deputetë. Megjithatë, vetëm 5 nga 24 ministra në qeverinë në largim ishin gra, dhe vetëm 6 nga 81 kryetarë të komunave janë gra. Të gjitha listat e paraqitura e plotësuan kuotën e kërkuar prej 40 përqind, e disa e tejkaluan këtë prag.²⁹ Gjithsej, 675 kandidatë të regjistruar (42 përqind) ishin gra, dhe gratë ishin bartëse të listave në 19 nga 78 listat.³⁰ Në listat e LSDM-së në çdo njësi zgjedhore, dy kandidatë të parë ishin një grua dhe një burrë. Listat e VMRO-DPMNE-së udhëhiqeshin nga gratë në dy njësi zgjedhore.

VIII. FUSHATA

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, periudha zyrtare e fushatës duhej të fillojë më 23 mars, 20 ditët para ditës së zgjedhjeve.³¹ Kodi Zgjedhor e ndalon zhvillimin e fushatës midis afatit të fundit për regjistrimin e kandidatëve (12 mars) dhe fillimit të fushatës zyrtare. Partitë politike zhvilluan disa aktivitete të fushatës para këtij moratoriumi. Në gjysmën e dytë të shkurtit, si LSDM-ja, ashtu edhe VMRO-DPMNE-ja mbajtën marshime në Shkup, me ç'rast e para i potencoi arritjet e qeverisë në largim në reformimin e gjyqësisë, ndërsa e dyta e akuzoi kryeministrin në largim për ndërhyrje në sistemin e drejtësisë. Dy liderët e këtyre partive mbajtën një debat televiziv më 28 shkurt, në të cilin gjendja u diskutua mjaft për gjyqësinë. LSDM-ja e mbajti kongresin e partisë më 9 mars, ndërsa VMRO-DPMNE-ja organizoi ngjarje partiake më 11 mars për t'i prezantuar kandidatët dhe partnerët e saj të koalicionit. Në disa qytete u shfaqën bilborde të fushatës. Këto aktivitete të hershme u karakterizuan me një diskurs shumë negativ, duke përfshirë posterë dhe incizime që pretendonin korrupsion ose ndërhyrje në gjyqësi nga personalitete udhëheqëse si të LSDM-së ashtu edhe të VMRO-DPMNE-së.

Aktivitetet potenciale të fushatës u kufizuan në mënyrë të konsiderueshme për shkak të shqetësimeve në rritje për shëndetin publik në lidhje me COVID-19. Më 10 mars, qeveria vendosi ndalesë për tubime publike dhe ngjarje me më shumë se 1.000 pjesëmarrës, në hapësira të mbyllura dhe të hapura, dhe rekomandoi anulimin e ngjarjeve me më pak se 1.000 pjesëmarrës. Kjo dhe masat e ngjashme, fillimisht kishin për qëllim të zgjasin deri në fillimin zyrtar të fushatës në 23 mars, mirëpo më në fund u zgjeruan dhe u zgjatën për një kohë të pacaktuar me vendimet pasuese. Pas një takimi të liderëve të partive më 12 mars, partitë ranë dakord të përmbahen nga mbajtja e tubimeve publike të fushatës, dhe të përqendrohen në zhvillimin e fushatës përmes mediave transmetuese, mediave onlajn dhe rrjeteve sociale, si dhe me bilborde. Si rezultat i kësaj, përgatitjet e partive për fushatën zyrtare, praktikisht, në pjesën më të madhe, u pezulluan, ndërsa partitë në disa rajone e informuan MVZ-në e ODIHR-it se aktivitetet e tyre nuk filluan fare.

²⁹ Të paktën një kandidat i secilës gjini duhet të vendoset në çdo tre vende në listë, dhe një kandidat shtesë në çdo dhjetë vende.

³⁰ Kjo përbën rreth 24 përqind. Në përputhje me reformat që përafrojnë ligjin kombëtar me legjislacionin e BE-së dhe pas ratifikimit të Konventës së Stambollit të Këshillit të Evropës në mars të vitit 2018, vendi u zotua ta lehtësojë pjesëmarrjen domethënëse të grave në jetën politike, duke përfshirë edhe në fushën e zgjedhjeve dhe të vendimmarrjes. [Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore për periudhën 2018-2020](#) parashikon masa që e lehtësojnë barazinë gjinore në administratën publike, duke përfshirë barazinë gjinore në administratën zgjedhore, mirëpo nuk janë zbatuar të gjitha masat e propozuara. [Strategjia Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim për periudhën 2016-2020](#) e obligon qeverinë t'i zbatojë standardet ndërkombëtare kundër diskriminimit.

³¹ Fushata përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Asnjë anketë zgjedhore nuk mund të publikohet pesë ditë para ditës së zgjedhjeve.

Korniza ligjore që synon luftimin e keqpërdorimit të burimeve administrative dhe korrupsionit është e gjerë dhe kohët e fundit u ndryshua në mënyrë thelbësore.³² Dispozitat që e ndalojnë përdorimin e burimeve administrative në fushatë përfshijnë moratorium për shpalljen e projekteve të reja të financuara me mjete publike dhe ndalesë për përdorimin e zyrave, pajisjeve apo punonjësve shtetërorë për fushatë, dhe presionin ndaj nëpunësve publikë. Pas shpalljes së zgjedhjeve, nuk mund të bëhen pagesa të rrogave, pensioneve dhe ndihmave sociale, përveç pagesave të rregullta, nga mjetet buxhetore. Me përjashtim të rasteve urgjente, punësimi i punonjësve të rinj në sektorin publik ose ndërprerja e punësimit të punonjësve ekzistues është e ndaluar, duke përfshirë edhe ato të iniciuara nga qeveria kalimtare.³³ Një ndryshim i fundit ofron sqarime se cilat janë rastet e tilla urgjente.

Njëra nga çështjet që u theksua në kongresin e LSDM-së ishte premtimi për kujdes më të mirë për më të prekurit, duke përfshirë personat me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Kreu i partisë premtoi rritje të ndihmave për personat me aftësi të kufizuara dhe se platformat hyrëse në të gjitha ndërtesat publike do të ishin të detyrueshme deri në vitin 2024. Në ngjarjen e VMRO-DPMNE-së për prezantimin e kandidatëve të saj kishte interpretim në gjuhën e shenjave.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga donacionet në para dhe ato në natyrë nga individë dhe persona juridikë, në vlerë deri në 3.000 dhe 30.000 eurosh, përkatësisht. Donacionet nga burime të huaja, komunale dhe anonime dhe ato nga organizatat në pronësi shtetërore, organizatat fetare dhe ato bamirëse janë të jashtëligjshme. Partitë mund t'i financojnë fushatat zgjedhore nga mjetet që i kanë në llogarinë e tyre të rregullt bankare, nga anëtarësia, donacionet dhe kreditë bankare të dedikuara për fushatat zgjedhore.³⁴ Shpenzimet e fushatës janë të kufizuara në rreth 2 euro për votues të regjistruar në një njësi zgjedhore. Partive u kërkohet të regjistrojnë një numër unik tatimor dhe të hapin një llogari të dedikuar transaksionesh për qëllime të financimit të fushatës.

Me ndryshimet e vitit 2020 në Kodin Zgjedhor u parashikua që një raport shtesë të dorëzohet 19 ditë pas ditës së zgjedhjeve dhe u shkurtua afati për dorëzimin e raportit përfundimtar nga 4 në 3 muaj pas zgjedhjeve. Duhet të dorëzohen edhe dy raporte të përkohshme: një në mes të fushatës, dhe një tjetër një ditë para zgjedhjeve, gjë që nuk lejon kohë për shqyrtim të detajuar ose për publikim para zgjedhjeve. Të katër raportet duhet t'i përcaktojnë në mënyrë të detajuar të ardhurat dhe shpenzimet dhe duhet të dorëzohen në KSHZ, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe

³² Duke përfshirë Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave, Ligjin për Lobimin dhe Ligjin për Mbrojtjen e Denoncuesve, Ligjin për Kontrollin Financiar Publik dhe një numër ligjesh që e rregullojnë punësimin në sektorin publik. [Raporti i Vlerësimit i Greco-s i vitit 2019 për Maqedoninë e Veriut](#) konkludoi se "fuqia e përgjithshme e kornizës për antikorrupsion është e diskutueshme pasi zbatimi i politikave dhe i ligjeve të ndryshme është i dobët dhe selektiv në praktikë, ndërsa ndryshimet e shpeshta të ligjeve kanë krijuar një mjedis në përgjithësi të paparashikueshëm dhe u kanë mundësuar zyrtarëve të korruptuar publikë të veprojnë pa u ndëshkuar".

³³ Ministri i Punëve të Brendshme i qeverisë kalimtare i kundërshtoi disa vendime qeveritare për punësime. Qeveria i [mohoi](#) shkeljet, ndërsa Prokuroria Publike [njoftoi](#) se kishte iniciuar fillimin e hetimeve.

³⁴ Partitë politike që fitojnë mbi një përqind të votave kanë të drejtë për financim publik. Sipas ndryshimit të vitit 2018 në Ligjin për Financimin e Partive Politike, subvencionet publike për partitë politike u rritën nga 0.06 përqind në 0.15 përqind të pjesës së të ardhurave të buxhetit vjetor (nga 1.8 milion në 4,5 milion euro). Sipas Ligjit, 70 përqind do të shpërndahen midis partive parlamentare në përpjesëtim me numrin e deputetëve. Në vitin 2020, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja kanë të drejtë të marrin 1.180.000 dhe 1.025.000 euro, përkatësisht. Me 21 mars, ministri i drejtësisë propozoi të shfuqizohen pagesat buxhetore për partitë politike si një masë kursyese e lidhur me COVID-19. As LSDM-ja, e as VMRO-DPMNE-ja, llogaritë partiake dhe pasuria e së cilës janë të ngrira që nga viti 2018 për shkak të hetimit të shkeljeve gjatë financimit të partisë, nuk e kundërshtuan këtë.

Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KShPK), me ç'rast secila prej tyre i publikon raportet e plota onlajn. Vetëm raporti përfundimtar i nënshtrohet revizionit të detyrueshëm. Zhvillimi i fushatës nga palët e treta dhe raportimi i shpenzimeve të bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët e pavarur mbeten të parregulluara.

Në vitin 2020, Kodi Zgjedhor u përafhua me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave të vitit 2019, duke e zhvendosur juridiksionin parësor për mbikëqyrjen e financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative të KShPK-ja. KShPK-ja ka për detyrë të kryejë monitorim të vazhdueshëm të financimit të fushatës gjatë gjithë periudhës zgjedhore, duke përfshirë aktivitetet financiare të partive politike dhe të zyrtarëve publikë, dhe të kërkojë të dhëna nga bankat dhe institucionet e tjera kompetente. Organi ka të drejtë të fillojë inspektive sipas detyrës zyrtare dhe t'i shqyrtojë kundërshtimet nga personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë nga garuesit, partitë dhe vëzhguesit e zgjedhjeve, dhe të iniciojë ndjekje penale në rast të shkeljeve dhe si reagim ndaj raporteve të ESHR-së.³⁵ ESHR-ja bën kontroll të mëvonshëm (*ex-post*) të financimit të fushatës duke u bazuar në revizionin e raportit përfundimtar. Kodi Zgjedhor krijon mundësi paralele për iniciimin e procedurave kundërvajtëse, pasi që ESHR-ja mund t'i raportojë shkeljet te prokurori ose të iniciojë drejtpërdrejt procedura kundërvajtëse. Me rekomandimin e ESHR-së, KSHZ-ja vendos për humbjen e kompensimit të shpenzimeve të fushatës në rast se raportohen parregullsi.³⁶

Një e treta e buxhetit për administrimin e zgjedhjeve është alokuar për t'i kompensuar pjesërisht shpenzimet e fushatës së pjesëmarrësve, kandidatët e të cilëve arrijnë të zgjidhen.³⁷ Të gjitha mjetet publike menaxhohen dhe shpërndahen nga KSHZ-ja, duke i përfshirë edhe ato për reklamat politike në media gjatë fushatës. Para pezullimit të aktiviteteve zgjedhore më 21 mars, nuk u shpërndanë mjetet publike për zhvillimin e fushatës.

Në përpjekje për ta kontrolluar keqpërdorimin e burimeve administrative dhe në përputhje me kërkesat ligjore, më 1 mars, Ministria e Financave dhe KSHZ-ja publikuan një raport financiar parazgjedhor me një përmbledhje të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të planifikuara dhe ekzekutuara nga buxheti i shtetit që nga fillimi i vitit fiskal. Raportet ditore për shpenzimet buxhetore që nga shpallja e zgjedhjeve deri më 21 mars gjithashtu u publikuan në ueb-faqen e ministrisë.³⁸

X. MEDIAT

Një numër i madh i mediave funksionojnë në një treg për reklamim që është duke u zvogëluar. Televizioni është burimi kryesor i informimit, e më pas vijnë mediat onlajn. Tirazhi i mediave të

³⁵ Më parë, kjo kompetencë ishte në kompetencë të ESHR-së. Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, KShPK-ja vazhdon të ketë mungesë të punonjësve dhe të kapacitetit për të kryer mbikëqyrje efektive të financimit të fushatës. Bashkëbiseduesit nga shoqëria civile deklaruan se nuk kishin ndërmend të marrin pjesë aktive në monitorimin e financimit të fushatës për shkak të mungesës së burimeve dhe qasjes së kufizuar në dokumentacionin financiar. Për dallim nga fushatat e mëparshme, nuk u nënshkrua asnjë memorandum bashkëpunimi midis KShPK-së dhe organizatave të shoqërisë civile.

³⁶ Vendimmarrja e KSHZ-së për humbjen e kompensimeve nuk është e rregulluar qartë; megjithëse vendimi i saj është përfundimtar, mund të pasojnë procedura administrative. Veprimet kundërvajtëse mund të sjellin humbje të pjesshme ose të plotë të kompensimit të shpenzimeve të fushatës ose pezullim të pagesës. Për shkeljet e rregullave të mbledhjes së mjeteve, tejkalimin e kufijve të fushatës, mosdorëzimin e raporteve ose dorëzimin e raporteve jo të sakta, keqpërdorimin e mjeteve publike dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore është paraparë dënim me burg.

³⁷ Gjithsej 9.165.910 euro u ndanë për administrimin e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe mjetet për financimin e fushatës.

³⁸ Në këto raporte ishin renditur shpenzimet ditore pa pasur referencë të kryqëzuar në buxhetin e planifikuar.

shkruara vazhdon të zvogëlohet, megjithëse shtypja dhe shpërndarja subvencionohet pjesërisht nga qeveria që nga viti 2018. Radio dhe Televizioni Publik i Maqedonisë (RTM) financohet ekskluzivisht nga buxheti i shtetit që nga viti 2017, gjë që u kritikua nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it pasi që e dëmton pavarësinë e tij redaktuese.

Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it e potencuan shumëllojshmërinë e përmirësuar të mbulimit të lajmeve, por gjithashtu vunë në dukje një nivel të ulët profesionalizmi dhe kushte të parregullta të punës në fushën e mediave.³⁹ Shumë bashkëbisedues e përmendën përdorimin e shtuar të mediave onlajn dhe të rrjeteve sociale për shpërndarjen e qëllimshme të informacionit mashtrues ose të rremë. Për ta adresuar këtë çështje, disa organizata të shquara profesionale të mediave, duke përfshirë edhe Shoqatën e Gazetarëve dhe Këshillin për Etikë në Media krijuan një Regjistër të mediave profesionale onlajn, të cilat janë të obliguara t'u përmbahen standardeve profesionale.⁴⁰ Megjithëse krijimi i regjistrit kryesisht u mirëprit nga bashkëbiseduesit MVZ-së së ODIHR-it, disa prej tyre vunë në dukje mungesën e edicioneve onlajn të transmetuesve të dalluar kombëtarë.

Kodi Zgjedhor parashikon rregullim të detajuar të sjelljes së mediave, duke filluar nga shpallja e zgjedhjeve e deri në periudhën e fushatës zgjedhore. Pasi të shpallen zgjedhjet, të gjithë transmetuesit dhe ueb-faqet që i mbulojnë zgjedhjet janë të obliguara ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Me ndryshimet që u bënë Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 transmetuesit kombëtarë janë të obliguar që mbulimin zgjedhor ta plotësojnë edhe me gjuhën e shenjave.

Lajmet e RTM-së gjatë fushatës i nënshtrohen rregullimit të përpiktë: 30 përqind e lajmeve duhet t'i kushtohen ngjarjeve të përgjithshme kombëtare dhe ndërkombëtare, 30 përqind partive në pushtet, 30 përqind opozitës parlamentare dhe 10 përqind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. Disa bashkëbisedues të MVZ-së ishin të mendimit se kërkesat e tilla janë të tepërta dhe e dëmtojnë pavarësinë redaktuese. Reklamat falas politike shpërndahen vetëm në transmetuesin publik; megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk specifikon asnjë dispozitë të qartë në lidhje me kohëzgjatjen ose kërkesat e tjera.

Reklamat e paguara politike në mediat private transmetuese, të shkruara dhe ato onlajn gjatë periudhës së fushatës janë të mbuluara nga buxheti i shtetit. Garuesve u ndahen nga 2 euro për votues të regjistruar: deri në 45 përqind për dy partitë më të mëdha në pushtet dhe deri në 45 përqind për dy partitë më të mëdha parlamentare opozitare.⁴¹ Partitë e tjera parlamentare dhe joparlamentare dhe kandidatët e pavarur nuk mund të marrin më shumë se 10 përqindëshin e mbetur të mjeteve. Kodi Zgjedhor nuk përcakton një formulë të detajuar të shpërndarjes së kohës dhe mjeteve brenda kategorive të lartpërmendura (gjegjësisht proporcionin e mjeteve që do të ndahen midis partisë së parë dhe të dytë, në pushtet ose opozitare).

³⁹ [Raporti i Përparimit i BE-së për vitin 2019](#) vuri në dukje përmirësimin e klimës për lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes, debatin e vazhdueshëm të hapur politik dhe raportimin kritik të mediave. Megjithatë, në të theksohet nevoja për ta përmirësuar pavarësinë, përshtatshmërinë financiare, standardet profesionale dhe cilësinë e gazetarisë, veçanërisht në mediat publike.

⁴⁰ Për t'u regjistruar në [Regjistrin e mediave profesionale onlajn](#), mediat duhet t'i respektojnë standardet profesionale dhe të sigurojnë informata për financimin, pronësinë dhe ekipin redaktues. Gjatë periudhës së raportimit, në këtë regjistër ishin regjistruar 103 ueb-faqe. SHGM-ja gjithashtu përgatiti udhëzime për raportimin etik gjatë zgjedhjeve.

⁴¹ KSHZ-ja i ngriti shqetësimet MVZ-së së ODIHR-it lidhur me mungesën e qartësisë në ndryshimet e bëra për sa i përket identifikimit dhe shpërndarjes së mëvonshme të mjeteve për Lëvizjen BESA, pasi kjo parti, megjithëse zyrtarisht ishte në opozitën parlamentare, ka formuar një koalicion parazgjedhor me LSDM-në në pushtet.

Të gjitha mediat e interesuara për të shitur hapësirë për reklama të paguara politike duhet të regjistrohen në KSHZ dhe duhet t'i dorëzojnë listat e çmimeve të tyre brenda tre ditëve nga shpallja e zgjedhjeve. KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se i mungon kapaciteti profesional dhe udhëzimet e duhura ligjore për verifikimin e aplikimeve për t'u regjistruar në regjistër. Kështu, procesi i regjistrimit për këto zgjedhje u bazua në njoftim, e jo në verifikimin e hollësishëm. Kjo rezultoi me regjistrimin e disa transmetuesve që nuk kishin licencë për funksionim në Maqedoninë e Veriut, të cilët u hoqën pasi organi rregullator i mediave e njoftoi KSHZ-në. Për më tepër, në mungesë të një përkufizimi të qartë të mediave onlajn, disa ueb-faqe regjistruan edicione në gjuhë në ndryshme ose domene të ndryshme të së njëjtës ueb-faqe si media të veçanta, duke e anashkaluar kufirin e caktuar në Kodin Zgjedhor për shpenzime të reklamave të një partie në një medie të shkruar ose medie onlajn (15.000 euro). Për këto zgjedhje, gjithsej 44 stacione televizive, 52 radiostacione, 12 media të shkruara dhe 230 ueb-faqe u regjistruan në KSHZ.

Për më tepër, ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor përcaktuan se shuma maksimale që mund t'i paguhej cilës do medie për reklama politike nuk mund ta tejkalojë çmimin mesatar të reklamimit që është përdorur gjatë pesë zgjedhjeve të mëparshme. KSHZ-ja është e obliguar me ligj t'i llogarisë këto mesatare; megjithatë, korniza ligjore nuk përcakton hollësi se si duhet të bëhen llogaritjet e tilla. KSHZ-ja vendosi ta llogarisë kufirin maksimal të çmimit për të gjitha mediat duke u bazuar vetëm në ato media që e ofruan hapësirën e tyre për reklamim në pesë zgjedhjet e fundit radhazi.⁴² Pesë transmetues televizivë kombëtarë i kontestuan pa sukses metodat për llogaritjet e tilla në Gjykatën Administrative, duke theksuar se KSHZ-ja nuk i kishte marrë parasysh specifikat e reklamave në mediat transmetuese, duke përfshirë çmimin më të lartë të periudhave me shikim më të madh (shih seksionin *Kundërshtimet dhe Ankesat*).

Respektimi i Kodit Zgjedhor nga ana e mediave transmetuese dhe mediave onlajn mbikëqyret nga organi kryesor rregullator i mediave, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM). Ky organ është i obliguar me ligj që t'i monitorojë transmetuesit nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e votimit. ASHAAM-i publikon raporte javore para fushatës dhe raporte ditore gjatë fushatës dhe ia dërgon ato KSHZ-së.⁴³ Në rast se identifikon ndonjë shkeljeve të mediave transmetuese, ASHAAM-i inicion procedurë kundërvajtëse brenda 48 orëve.⁴⁴ Më 17 shkurt, ASHAAM-i filloi monitorimin e dhjetë transmetuesve kombëtarë dhe dorëzoi katër raporte javore në KSHZ para se ta pezullojë monitorimin më 16 mars. Raporti i fundit i ASHAAM-it, i publikuar në 26 mars, tregoi se ky monitorim i mediave nuk kishte identifikuar asnjë shkelje të ligjit.⁴⁵ Raporti vuri në dukje se *TV Alfa* shfaqti një qëndrim kritik ndaj aktiviteteve të qeverisë dhe të LSDM-së, ndërsa për VMRO-DPMNE-në raportoi në mënyrë pozitive ose neutrale.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Maqedonia e Veriut është një vend etnikisht i larmishëm. Korniza kombëtare ligjore i përmend bashkësitë etnike, ndërsa Kushtetuta e garanton mbrojtjen e tyre. Shprehja 'bashkësitë më të vogla' përdoret për t'iu referuar bashkësive që përbëjnë më pak se 20 përqind të popullsisë së

⁴² KSHZ-ja vendosi të përdorë një çmim mesatar duke u bazuar në listat e çmimeve të mëparshme të gjashtë televizioneve kryesore kombëtare, tre radiove kombëtare dhe tre gazetave ditore si bazë për llogaritjet e saj. Më 16 shkurt, KSHZ-ja përcaktoi se çmimi maksimal për një reklamë të paguar politike në televizion është 1.83 euro për sekondë, në radio 0.66 euro për sekondë, në mediat e shkruara 405 euro për një faqe bardhë e zi dhe 530 euro për një faqe me ngjyra.

⁴³ ASHAAM-i gjithashtu duhet ta bëjë monitorimin e reklamave politike në mediat transmetuese gjatë periudhës së fushatës dhe ta verifikojë praninë e tyre në përputhje me kontratat e nënshkruara. Ky monitorim duhet të shërbejë si bazë për pagesat për transmetuesit nga ana e KSHZ-së.

⁴⁴ Kjo mund të rezultojë me gjobë prej 800 euro deri në 4.000 euro.

⁴⁵ Shih [Raportin e ASHAAM-it](#) (në gjuhën maqedonase).

përgjithshme.⁴⁶ Regjistrimi i fundit i popullsisë u krye në vitin 2002. Korniza ligjore nuk garanton vende në parlament për asnjë bashkësi etnike. Rreth 19 përqind e deputetëve në parlamentin në largim u identifikuan si shqiptarë etnikë.

Partitë tradicionalisht kanë garuar për vota kryesisht brenda bashkësive të tyre etnike, ndërsa koalicionet në pushtet janë formuar përtej ndarjes etnike, duke i përfshirë partitë etnike shqiptare. Megjithatë, që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, LSDM-ja ka bërë përpjekje për të fituar mbështetje nga votuesit shqiptarë etnikë. Në zgjedhjet komunale të vitit 2017, LSDM-ja dhe BDI-ja i mbështetën kandidatët e njëri-tjetrit në disa gara për kryetarë të komunave. Në një moment kthese, në zgjedhjet presidenciale të vitit 2019, Stevo Pendarovski u zgjodh me mbështetjen e dy partive kryesisht të maqedonasve etnikë (LSDM) dhe të partive të shqiptarëve etnikë (BDI-së, Partisë Demokratike Shqiptare dhe partisë AlternAtivA). Një moment tjetër i rëndësishëm ndodhi në shkurt të vitit 2020, kur LSDM-ja formoi një aleancë parazgjedhore me Lëvizjen BESA, ku për herë të parë dy parti, kryesisht të lidhura me maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë, formuan një aleancë të tillë përpara zgjedhjeve parlamentare. Partitë që i përfaqësojnë pakicat kombëtare morën pjesë në koalicionet e udhëhequra nga LSDM-ja dhe VMRO-ja. Të dy listat përfshinin kandidatë nga të dy bashkësitë etnike.

XII. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Shumica e kundërshtimeve në lidhje me zgjedhjet janë në kompetencën e KSHZ-së. Në ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor dhe rregulloret pasuese të KSHZ-së, u qartësuan kompetencat e KZK-ve për t'i përfshirë kundërshtimet e ditës së zgjedhjeve për regjistrimin e votuesve. Gjykatat themelore i shqyrtojnë pretendimet në lidhje me shkeljet zgjedhore dhe kundërshtimet e garuesve për ndërhyrje në aktivitetet e tyre të fushatës, ndërsa KSHZ-ja i shqyrton pretendimet për shkelje të tjera të fushatës.⁴⁷ KSHPK-ja merret me kundërshtimet në lidhje me fushatën dhe financimin politik, si dhe me keqpërdorimin e burimeve administrative. Gjykata Administrative është shkalla e fundit e ankimit për shumicën e kundërshtimeve, ndërsa në vitin 2020 kompetencat e saj u zgjeruan.⁴⁸

Votuesit kanë bazë të kufizuar ligjore për të iniciuar konteste zgjedhore dhe kanë të drejtë të ankohen për shkeljen e të drejtave të tyre individuale të votimit. Parregullsitë zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve mund të kontestohen nga parashtruesit e listave të kandidatëve. Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e partive mund t'i shënojnë vërejtjet e tyre për parregullsitë e vëzhguara në procesverbalet e KZ-ve, të cilat mund të kundërshtohen në një fazë të mëvonshme nga parashtruesit e listave. Sipas rregullave të reja, KSHZ-së i kërkohet që t'i hetojë parregullsitë dhe shkeljet e pretenduara para se të marrë vendim⁴⁹

Afatet për të vendosur në lidhje me kundërshtimet në përgjithësi janë të shkurtra; kundërshtimet e ditës së zgjedhjeve shqyrtohen brenda katër orësh. Kundërshtimet mund të parashtrohen në mënyrë

⁴⁶ Sipas regjistrimit të vitit 2002, maqedonasit etnikë përbëjnë 64.1 përqind, ndërsa shqiptarët etnikë për 25.1 përqind të popullsisë. Kategoria 'bashkësi më të vogla' i përfshin turqit (3.85 përqind), romët (2.66 përqind), serbët (1.78 përqind), boshnjakët (0.84 përqind), vllahët (0.48 përqind) dhe të tjerët (1.04 përqind).

⁴⁷ Duke përfshirë shkeljet e rregullave për organizimin e tubimeve, fjalimet publike të kandidatëve, fushatat në media, etj.

⁴⁸ Ndryshimet parashikuan mundësinë për t'u ankuar kundër vendimeve të KSHZ-së për parregullsitë në fushatë. Asnjë mjet efektiv ligjor nuk është i parashikuar për regjistrimin e votuesve në institucionet e kujdesit dhe institucionet ndëshkuese.

⁴⁹ KSHZ-ja e vlerësoi negativisht këtë kërkesë të re, për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore që i ka në dispozicion dhe afateve të shkurtra që potencialisht që mund të çojnë në grumbullim të kundërshtimeve.

indirekte, megjithatë, nuk ka ndonjë afat kohor për transferimin e tyre në shkallë më të larta.⁵⁰ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, sistemi onlajn për parashtrimin e kundërshtimeve nuk ishte funksional.⁵¹

KSHZ-ja raportoi se kishte pranuar shumë pak kundërshtime deri më 21 mars. Ato kryesisht kishin të bëjnë me regjistrimin e votuesve që banojnë jashtë vendit dhe me mediat.⁵² Nga 15 kundërshtime në lidhje me zgjedhjet që i pranoi Gjykata Administrative, 6 u parashtruan nga mediat që i kontestuan pa sukses vendimet dhe udhëzimet e KSHZ-së për çmimet e reklamave politike në mediat transmetuese dhe për refuzimin e aplikimeve të disa mediave për t'u regjistruar në Regjistrin e transmetuesve, mediave të shkruara dhe atyre elektronike, që u jep të drejtë mediave të marrin mjete publike për reklama politike gjatë fushatës.⁵³ Një numër i kundërshtimeve i kontestuan publikimet në ueb-faqen e KSHZ-së, duke pretenduar se kanë zbuluar të dhëna personale.⁵⁴

Ndryshimet e vitit 2020 në Kodin Zgjedhor i forcuan masat e transparencës për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore duke parashikuar seancë të detyrueshme publike. Gjykata Administrative e informoi MVZ-në e ODIHR-it se për shkak të hapësirave të vogla dhe të kufizuara që aktualisht i janë ndarë Gjykatës, mbajtja e seancave publike për të gjitha rastet që priten gjatë procesit zgjedhor paraqet sfidë për të. Miratimi i masave të shëndetit publik dhe i kufizimeve të tjera në lidhje me COVID-19 ndikuan edhe më shumë në zbatimin e këtij ndryshimi. Më 17 Mars, Këshilli Gjyqësor u kërkoi të gjitha gjykatave që t'i kufizojnë aktivitetet e tyre vetëm në procedurat urgjente dhe në rastet që kërkojnë shqyrtim të shpejtë. Në përputhje me këtë, Gjykata Administrative vendosi t'i shtyjë seancat publike dhe ta kufizojë hyrjen në ambientet e Gjykatës.⁵⁵ Një dekret i qeverisë i datës 30 mars i pezulloi të gjitha afatet e procedurave hetimore, si dhe afatet e procedurave për të marrë vendime gjyqësore për të gjitha kategoritë e kontesteve.

⁵⁰ KZK-të i transferojnë kundërshtimet kundër vendimeve të tyre në KSHZ, ndërsa ankesat ndaj vendimeve të KSHZ-së mund të parashtrihen në Gjykatën Administrative përmes KSHZ-së.

⁵¹ Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nga gjyqësia shprehën skepticizëm në lidhje me efikasitetin e aplikacionit onlajn për parashtrimin e kundërshtimeve, pasi nuk ekziston një sistem gjithëpërfshirës funksional që do të mund t'i sinkronizonte aktgjykimet dhe vendimet administrative për të njëjtat raste që janë miratuar nga institucione të ndryshme anembanë vendit.

⁵² Të gjitha kundërshtimet u refuzuan. KSHZ-ja gjithashtu refuzoi një kërkesë të Aleancës për Shqiptarët për t'ia ndarë kësaj partie kuotën e opozitës për anëtarë të KZ-ve, pasi që, sipas mendimit të tyre, ata mbetën partia e vetme parlamentare opozitare pas formimit të marrëveshjes së koalicionit parazgjedhor të vitit 2020 midis Lëvizjes BESA dhe LSDM-së. Gjykata Administrative e refuzoi ankesën si të papranueshme.

⁵³ Kundërshtimet nga një numër stacionesh televizive kombëtare në lidhje me [Udhëzimin Nr. 10-475/1](#) dhe [Vendimin nr. 10-476/1](#) të 16 shkurtit të vitit 2020, në lidhje me procedurat e llogaritjes dhe miratimit të çmimeve maksimale të reklamave të paguara politike, u refuzuan si të papranueshme dhe të pabazuara. Gjykata Administrative i pranoi katër refuzime të KSHZ-së për ta regjistruar televizionin lokal *Kobra* dhe tre portale onlajn në Regjistrin e mediave për shkak të mangësive në aplikim. Në tre raste, Gjykata u pajtua me interpretimin e KSHZ-së se regjistrimi është i kushtëzuar me dorëzimin e certifikatave sipas nenit 75-f dhe e vërtetoi refuzimin e KSHZ-së për shkak se TV *Kobra* nuk e kishte harmonizuar listën e çmimeve me udhëzimin e KSHZ-së. Gjashtë ankesa shtesë ndaj vendimeve të KSHZ-së lidhur me regjistrimin e votuesve u pranuan nga Gjykata. Dy ankesa nga zëvendësministri i financave i qeverisë kalimtare që e kontestuan refuzimin e KSHZ-së për t'i rishikuar vendimet e miratuara nga ministri i financave për shkeljen e pretenduar të rregullave për emërim në institucionet e sektorit publik gjatë zgjedhjeve, u hodhën poshtë nga Gjykata si të pabazuara. Këto vendime nuk u publikuan në ueb-faqen e Gjykatës.

⁵⁴ OSHC-ja "Diaspora e Bashkuar Maqedonase" [pretendoj](#) shkelje në shkallë të gjerë të të drejtave të votuesve gjatë regjistrimit për votim jashtë vendit, duke përfshirë edhe [zbulimin e të dhënave personale](#), ndërsa 12 kundërshtime nga votuesit u parashtruan në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, Agjencia i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet nga individët dhe e pranoi publikimin onlajn të regjistrimit të votuesve si të ligjshëm. Agjencia gjithashtu pranoi një kërkesë nga OSHC-ja "Lëvizja Koncepti Maqedonas" për ta hetuar zbulimin e paligjshëm të të dhënave personale të kandidatëve nga ana e KSHZ-së pas publikimit të listave të kandidatëve në ueb-faqen e KSHZ-së; një kundërshtim i ngjashëm ishte parashtruar në Prokurorinë Publike nga një parashtrues i listës së kandidatëve.

⁵⁵ Shih [vendimin](#) e Gjykatës Administrative (në gjuhën maqedonase).

XIII. VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgim qytetar, partiak dhe ndërkombëtar. Procesi i akreditimit është i centralizuar dhe organizatat e akredituara janë të renditura në ueb-faqen e KSHZ-së, ndërsa përgjegjësia për regjistrimin e përfaqësuesve të kandidatëve u takon KZK-ve. Më 19 shkurt, KSHZ-ja e miratoi Kodin e sjelljes së vëzhguesve, i cili është i detyrueshëm për të gjitha organet e akredituara. Dy organizata të shquara të shoqërisë civile kishin ndërmend t'i vëzhgojnë këto zgjedhje: MOST dhe CIVIL.

XIV. PEZULLIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

Më 13 mars, kryetari i shtetit thirri mbledhje të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për t'i diskutuar masat e COVID-19, duke përfshirë alternativa për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme mbarëkombëtare. Në të njëjtën ditë, gjendje krize u shpall në dy komuna, në Qendrën Zhupa dhe në Dibër, me ç'rast hyrja dhe dalja ishin të kufizuara vetëm për furnizime thelbësore dhe raste urgjente mjekësore.

Në mbledhjen e mbajtur më 15 mars, KSHZ-ja sugjeroi se, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, duhet të merret parasysh shtyrja e zgjedhjeve në interes të shëndetit publik.⁵⁶ Në të njëjtën kohë, KSHZ-ja e siguroi publikun se, deri sa të merret një vendim i tillë, përgatitjet për zgjedhje do të vazhdonin pa ndërprerje. Më 16 mars, Këshilli i Sigurisë Kombëtare vendosi njëzëri kundër shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në gjithë territorin e vendit. Kryetarët e partive u takuan më 17 mars dhe unanimisht rekomanduan shtyrjen e procesit zgjedhor. Kryetari i vendit mbledhi një grup ekspertësh të të drejtës kushtetuese për t'u këshilluar për modalitetet e duhura ligjore për ndryshimin e datës së zgjedhjeve.⁵⁷

Më 18 mars, qeveria kalimtare kërkoi nga parlamenti që të rimblidhet për të vendosur për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.⁵⁸ Kryetari i Kuvendit në largim ia përcolli propozimin kryetarit të vendit, i cili miratoi një dekret për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme 30-ditore dhe për zgjatjen e qeverisë kalimtare.⁵⁹ Më 21 mars, 22 ditë para ditës së zgjedhjeve, qeveria miratoi një dekret me fuqinë e ligjit për përfundimin e të gjitha aktiviteteve që ishin në realizim e sipër në

⁵⁶ KSHZ-ja po ashtu e përmendi mundësinë për pjesëmarrje të ulët të votuesve dhe për rrezikun e shtuar të ekspozimit të anëtarëve të KZ-ve në ditën e zgjedhjeve. Procesverbali i kësaj mbledhjeje nuk u publikua, por vërejtjet u publikuan gjerësisht në media.

⁵⁷ Kryetari i Kuvendit në largim ishte i pranishëm në të gjitha takimet në cilësinë e tij zyrtare, përkundër shpërbërjes së mëparshme të parlamentit.

⁵⁸ KSHZ-ja deklaroi se mandati i përbërjes aktuale të Kuvendit mbetet i vlefshëm deri në formimin e Kuvendit të ri, dhe për këtë arsye Kuvendi mund të rimblidhet për të caktuar një datë të re për zgjedhjet. Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën për ta shqyrtuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimit për shpërbërjen e Kuvendit. Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese konstatoi se mandati i Kuvendit përfundon pas shpërbërjes, pa pasur mundësi për t'u rimbledhur.

⁵⁹ Kushtetuta parashikon se në rast të epidemive mund të caktohet gjendje e jashtëzakonshme me shumicë prej dy të tretave të Kuvendit, me propozim të kryetarit të vendit, qeverisë, ose së paku të 30 deputetëve, dhe mund të zgjasë më së shumti 30 ditë. Në rast se Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme e merr kryetari i vendit dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim sapo ai të ketë mundësi të mblidhet. Gjendja e jashtëzakonshme ndërpritet nga parlamenti. Kushtetuta gjithashtu parashikon se gjatë gjendjes së jashtëzakonshme mandati i kryeministrit nuk do të ndërpritet.

lidhje me zgjedhjet.⁶⁰ Sipas dekretit, procesi zgjedhor do të vazhdojë nga dita e ndërprerjes së gjendjes së jashtëzakonshme. Sipas dekretit, KSHZ-ja ka për detyrë ta mirëmbajë të gjithë dokumentacionin zgjedhor dhe të krijojë një kalendar të ri zgjedhor, u vazhdua mandati i KSHZ-së për gjashtë muaj nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve të reja parlamentare, dhe u ndërpre zbatimi i rregullave që kufizojnë përdorimin e burimeve shtetërore, investimet, pagesat dhe punësimet, që u vendosën për periudhën e kohëzgjatjes së procesit zgjedhor. Rrjedhimisht, më 22 mars, KSHZ-ja mori vendim për pezullimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore. Të gjitha zhvillimet e mësipërme u mbështetën nga të gjitha partitë politike, duke përfshirë edhe opozitën. Me 16 prill, kryetari i vendit shpalli gjendje të re të jashtëzakonshme për një periudhë tjetër 30-ditore.⁶¹

XV. AKTIVITETET E MVZ-SË SË ODIHR-IT

MVZ-ja e ODIHR-it e filloi punën e saj më 2 mars. Shefi i MVZ-së së ODIHR-it u takua me kryetarin e vendit, ministrin e punëve të jashtme, kryetarin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kryetarin e Gjykatës Administrative, kandidatët dhe kryetarët e partive, si dhe përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së. MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu vendosi kontakte me shoqërinë civile, përfaqësuesit e mediave dhe palët e tjera të përfshira në procesin zgjedhor.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*

⁶⁰ Në përputhje me Kushtetutën, qeveria është e autorizuar që gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të miratojë dekrete me fuqi të ligjit. Ligji për Qeverinë parashikon se, në rastet kur Kuvendi nuk mund të mbledhet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, qeveria mund të miratojë dekrete me fuqi të ligjit për çështje që zakonisht janë në fushën e kompetencës së Kuvendit, si dhe masa urgjente që janë të nevojshme në rast emergjence, me kusht që dekreti të mbështetet nga shumica e anëtarëve të qeverisë që marrin pjesë në mbledhje.

⁶¹ Meqenëse Kushtetuta nuk parashikon mundësi për ta zgjatur gjendjen e jashtëzakonshme, i gjithë procesi u përsërit. Pas disa refuzimeve nga kryetari i Kuvendit për ta mbledhur përsëri Kuvendin, kryetari i vendit veprroi me kërkesë të qeverisë, pas konsultimeve me Këshillin e Sigurisë Kombëtare.